



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07

**Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendos:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 24 dhjetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim për rishikimin e paraburgimit të Nasim Haradinajt**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtësit të Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) kërkoi arrestimin e Hysni Gucati (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”) për shpërndarjen e pretenduar të informacionit konfidencial lidhur me punën e Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”) dhe/ose të ZPS-së në tri konferenca për shtyp të mbajtura më 7, 16 dhe 22 shtator 2020 (të quajtura, përkatësisht, “konferenca e parë për shtyp”, “konferenca e dytë për shtyp” dhe “konferenca e tretë për shtyp”) dhe kërkoi transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”).<sup>2</sup>
2. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi fletarrestimet për z. Gucati dhe z. Haradinaj për tentim të frikësimit të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, dhe urdhëroi transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të DHS-së (“Vendimi për arrestim dhe transferim”).<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik. Para këtij vendimi, Kryetarja e kishte caktuar të njëjtin gjykatës si Gjykatës të Vetëm; shih KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00009/RED, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për fletarrestime dhe për urdhra në lidhje me to, parashtrimi KSC-BC-2020-07/F0009 i datës 22 shtator 2020*, 22 shtator 2020, publik, para. 1, 35(a); me shtojcat 1-2, publike.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00012, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi kërkesën për arrestime dhe urdhra transferimi (“Vendimi për arrestim dhe transferim”)*, 24 shtator 2020, publik, para. 36, me shtojcat 1-4, publike.

3. Z. Haradinaj u arrestua më 25 shtator 2020<sup>4</sup> dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së ditën e nesërme.<sup>5</sup>
4. Më 26 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm u njoftua për caktimin e Bastian Martensit ("z. Martens") si mbrojtës kujdestar i z. Haradinaj.<sup>6</sup>
5. Më 29 shtator 2020, z. Haradinaj paraqiti kërkesë për lirimin e tij të menjëhershëm nga paraburgimi.<sup>7</sup> Më 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm nxori vendimin që hidhte poshtë këtë kërkesë ("Vendimi i parë për paraburgimin").<sup>8</sup>
6. Më 30 tetor 2020, ZPS-ja paraqiti për konfirmim aktakuzën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* ("Aktakuza") kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj, së bashku me materialin e provave në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat si dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.<sup>9</sup>
7. Më 2 dhjetor 2020, Administratorja e njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për emërimin e z. Martens si mbrojtës i z. Haradinaj.<sup>10</sup>

---

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për Nasim Haradinajn* ("Fletarrestimi"), 24 shtator 2020, publik; F00016, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, KSC-BC-2020-07, F00012/A04/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik; F00020, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale; F00026/COR, Administratorja, *Raport i korrigjuar mbi arrestimin dhe transferimin e Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit*, 28 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i F00026 u protokollua më 14 tetor 2020, shih F00026/COR/RED.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, F00020, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, publik, para. 3, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-07, F00030, Mbrojtja, *Paraqitja e parë, mocioni paraprak për hedhjen poshtë të akuzave dhe mocioni për lirim të menjëhershëm*, 29 shtator 2020, publike.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, F00058, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi kërkesën për lirim të menjëhershëm të Nasim Haradinajt*, 27 tetor 2020, publik.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-07, F00063, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i aktakuzës për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të 30 tetor 2020*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1 dhe 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-07, F00071, Administratorja, *Njoftim i emërimit të mbrojtësit të Nasim Haradinajt*, 2 dhjetor 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

8. Më 9 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkoi nga palët që deri më 18 dhjetor 2020 të dorëzonin parashtrime me shkrim lidhur me vazhdimin e paraburgimit të z. Haradinaj.<sup>11</sup>

9. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konfirmoi pjesërisht aktakuzën dhe urdhëroi ZPS-në që të paraqiste aktakuzën e rishikuar, të konfirmuar (“Aktakuza e Konfirmuar”).<sup>12</sup>

10. Më 14 dhjetor 2020, ZPS-ja paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar,<sup>13</sup> me redaktime, të autorizuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>14</sup> Në Aktakuzën e Konfirmuar, z. Gucati dhe z. Haradinaj akuzohen për kryerjen e veprave penale sipas neneve 387, 388, 392 dhe 401 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 (“KPK”), në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.<sup>15</sup>

11. Më 17 dhjetor 2020, z. Hendrik Sitema (z. Sitema) u miratua si bashkëmbrojtës i z. Haradinaj.<sup>16</sup>

12. Më 18 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi tërheqjen e z. Martens si mbrojtës i z. Haradinaj.<sup>17</sup> Menjëherë pas kësaj, Tobi Kadman (“z. Kadman”)

---

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-07, F00073, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për parashtrime në lidhje me rishikimin e paraburgimit*, 9 dhjetor 2020, publik.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-07, F00074/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e aktakuzës* (“Vendimi i konfirmimit”), 11 dhjetor 2020, publik.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-07, F00075, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimi i aktakuzës së konfirmuar*, 14 dhjetor 2020, publik, me shtojcën 1 (“Aktakuza e Konfirmuar”), rreptësisht konfidenciale, dhe shtojca 2 (“Aktakuza e konfirmuar e redaktuar publike”), publike.

<sup>14</sup> Vendimi i konfirmimit, para. 155(c).

<sup>15</sup> Aktakuza e konfirmuar e redaktuar publike, para. 48.

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-07, F00082, Administratorja, *Njoftim i miratimit të bashkëmbrojtësit të Nasim Haradinajt* (“Njoftimi për bashkëmbrojtësin”), 17 dhjetor 2020, publik, para. 5, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>17</sup> KSC-BC-2020-07, F00084, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për miratimin e tërheqjes së mbrojtësit*, 18 dhjetor 2020, konfidencial.

u emërua mbrojtës i z. Haradinaj.<sup>18</sup> Paraqitja e parë e z. Haradinaj u mbajt më të njëjtën ditë.<sup>19</sup>

13. Më 18 dhjetor 2020, z. Haradinaj paraqiti “Parashtrime në lidhje me rishikimin e paraburgimit deri më 27 dhjetor 2020”.<sup>20</sup> “Parashtrimet përmbledhëse të Prokurorisë për rishikimin e paraburgimit” gjithashtu u dorëzuan atë ditë.<sup>21</sup>

14. Më 21 dhjetor 2020, z. Karl Bakli (Carl Buckley) (“z. Bakli”) u miratua si bashkëmbrojtës i z. Haradinaj.<sup>22</sup>

## II. PARASHTRIMET

15. Z. Haradinaj parashtroi se nuk ka justifikim të përshtatshëm për vazhdimin e paraburgimit dhe se rrjedhimisht duhet të lirohet menjëherë, me ose pa kushte.<sup>23</sup> Ai gjithashtu kërkon zgjatjen e afatit për dorëzimin e parashtrimeve në lidhje me paraburgimin<sup>24</sup> dhe që gjithsesi, rishikimi i paraburgimit të trajtohet në një seancë gojore.<sup>25</sup>

16. ZPS-ja parashtroi se vazhdimi i paraburgimit mbetet i domosdoshëm meqenëse nuk ka ndryshim në rrethana që i zhvlerësojnë arsyet e përcaktuara për paraburgim.<sup>26</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtroi se rreziqet e nenit 41(6)(b) janë shtuar që nga vendimi i

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-07, F00086, Administratorja, *Njoftim i emërimit të mbrojtësit të Nasim Haradinajt*, 18 dhjetor 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>19</sup> KSC-BC-2020-07, F00081, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i dytë për ndryshimin e orarit të seancës së paraqitjes së parë të z. Gucati dhe z. Haradinaj*, 17 dhjetor 2020, publik.

<sup>20</sup> KSC-BC-2020-07, F00090, Mbrojtja, *Parashtrim në lidhje me rishikimin e paraburgimit deri më 27 dhjetor 2020*, 18 dhjetor 2020, publik. Versioni i korrigjuar, F00090/COR, u protokollua më 21 dhjetor 2020 (“Parashtrimi i Mbrojtjes”).

<sup>21</sup> KSC-BC-2020-07, F00088, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime përmbledhëse të Prokurorisë në lidhje me rishikimin e paraburgimit* (“Parashtrim i ZPS-së”), 18 dhjetor 2020, publik.

<sup>22</sup> KSC-BC-2020-07, F00092, Administratorja, *Njoftim i miratimit të bashkëmbrojtësit të Nasim Haradinajt*, 23 dhjetor 2020, publik, para. 10, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>23</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 1, 18(b).

<sup>24</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 18(a), 19-28.

<sup>25</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 18(a), 19-28.

<sup>26</sup> Parashtrimi i ZPS, para. 1.

fundit për paraburgim.<sup>27</sup> ZPS-ja vë në dukje faktin se tani ekziston konstatimi shtesë i dyshimit të bazuar se z. Gucati ka kryer shkeljen e pengimit të personave zyrtarë në ushtrimin e detyrave zyrtare sipas nenit 401 të KPK-së.<sup>28</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtron se Aktakuza e Konfirmuar pretendon vepra që shkojnë përtej atyre të përmendura në fletarrestim dhe në vendimin e parë për paraburgimin, duke qartësuar kështu natyrën e rëndë të akuzave dhe duke e bërë edhe më konkrete mundësinë e dënimit.<sup>29</sup> ZPS-ja pretendon se këto rreziqe në rritje mund të trajtohen në mënyrë të efektshme vetëm nga objekti i paraburgimit të DHS-së.<sup>30</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

17. Neni 41(6) i Ligjit përcakton se DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshim i bazuar se ai ka kryer vepër penale që është nën juridiksionin e DHS-së; dhe ekzistojnë arsye të artikulueshme të besohet se (i) ekziston rreziku i arratisjes; (ii) personi do të shkatërrojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova ose se rrethana të caktuara tregojnë se personi do ta pengojë ecurinë e procedimit penal; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar ta kryejë.

18. Neni 41(10) i Ligjit përcakton se, deri në momentin kur aktgjykimi të jetë i formës së prerë, ose deri në lirim pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për mbajtje në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me këtë çështje shqyrton se a ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe jep vendimin për vazhdimin ose përfundimin e paraburgimit.

19. Neni 41(12) i Ligjit përcakton se, përveç paraburgimit, mund të urdhërohen masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e

---

<sup>27</sup> Parashtrimi i ZPS-së, para. 1.

<sup>28</sup> Parashtrimi i ZPS-së, para. 3.

<sup>29</sup> Parashtrimi i ZPS-së, para. 4.

<sup>30</sup> Parashtrimi i ZPS-së, para. 4-5.

krimeve ose për të siguruar zhvillim të suksesshëm të procedimit penal: fletëthirja, fletarrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në një vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

20. Në përputhje me rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rishikon vendimin për paraburgim pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për paraburgim.

#### IV. DISKUTIM

21. Neni 41(10) i Ligjit e obligon Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të shqyrtojë nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim, duke përfshirë edhe argumentet e parapara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht (i) a ekziston dyshim i bazuar se personi e/i ka kryer krimin/krimet; dhe (ii) a ka arsye të artikulueshme për të besuar se është plotësuar ndonjë nga kriteret e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit. Vendimi në vijim i trajton kriteret e nenit 41(6) të Ligjit brenda kornizës së parashtrimeve nga palët.

##### A. KËRKESË PËR ZGJATJEN E AFATIT

22. Z. Haradinaj parashtron se emërimi i z. Kadman për të zëvendësuar mbrojtësin e tij të mëparshëm ndodhi fill para paraqitjes së tij të parë më 18 dhjetor 2020 dhe vetëm disa orë para afatit për dorëzimin e parashtrimeve në lidhje me rishikimin e paraburgimit dhe, në këto rrethana, mosmiratimi i zgjatjes së afatit për dorëzimin e parashtrimeve për paraburgimin deri më 21 dhjetor 2020 ishte në kundërshtim me parimet e drejtësisë.<sup>31</sup> Z. Haradinaj parashtron se, megjithëse ishte përgjegjësi e mbrojtësit të mëparshëm që të dorëzonte parashtrimet përkatëse brenda afatit të

---

<sup>31</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 19-25.

duhur, kjo mangësi nuk duhet të shkaktojë dëm ndaj tij.<sup>32</sup> Z. Haradinaj gjithashtu parashtron se zgjatja e afatit për dorëzimin e parashtrimeve deri më 21 dhjetor 2020, nuk e vonon afatin e 27 dhjetorit 2020 për rishikimin dymujor të paraburgimit.<sup>33</sup>

23. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se e ka refuzuar kërkesën e z. Haradinaj për zgjatjen e afatit të dorëzimit të parashtrimeve në lidhje me rishikimin e paraburgimit në paraqitjen e parë.<sup>34</sup> Z. Haradinaj në thelb kërkon rishikimin e këtij vendimi.

24. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se rishikimi është masë e jashtëzakonshme dhe në varësi të kushteve të veçanta të përcaktuara në rregullën 79 të Rregullores.<sup>35</sup> Në këtë aspekt, z. Haradinaj nuk demonstroi ndonjë gabim të qartë në arsyetim e as se rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësi. Argumentet e ngritura nga z. Haradinaj janë në thelb të njëjta me ato të ngritura gjatë paraqitjes së parë, të cilat janë trajtuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Nuk janë paraqitur fakte apo argumente të reja që nga ajo seancë. Përveç arsyeve që tashmë janë dhënë,<sup>36</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se (i) paraqitja e parë u shty me kërkesë të z. Haradinaj;<sup>37</sup> (ii) z. Haradinaj zgjodhi që ta ndryshonte mbrojtësin në prag të paraqitjes së tij të parë; (iii) që nga 17 dhjetori 2020, z. Haradinaj është ndihmuar nga bashkëmbrojtësi, Hendrik Sitema,<sup>38</sup> dhe, më e rëndësishme, (iv) mbrojtësi i ri i z. Haradinaj, z. Kadman, paraqiti parashtrime të gjerësishme në lidhje me vazhdimin e paraburgimit brenda afatit ekzistues, pas refuzimit të kërkesës së tij gojore për ndryshimin e afatit.

---

<sup>32</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 26.

<sup>33</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 27.

<sup>34</sup> Transkripti i seancës, 18 dhjetor 2020, f. 61, rreshti 9, deri në f. 64, rreshti 8.

<sup>35</sup> *Ngjashëm*, KSC-BC-2020-05, F00046, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, „Vendim në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për rishikim ose leje për apelim”, 5 nëntor 2020, publik, para. 14.

<sup>36</sup> Transkripti i seancës, 18 dhjetor 2020, f. 61, rreshti 22, deri në f. 62, rreshti 14; f. 63, rreshti 23, deri në f. 64, rreshti 8.

<sup>37</sup> KSC-BC-2020-07, F00077, Mbrojtja, *Kërkesë urgjente për shtyrjen e paraqitjes së parë për 18 dhjetor 2020*, 14 dhjetor 2020 (e protokolluar më 15 dhjetor 2020), publike, para. 4.

<sup>38</sup> Njoftimi për bashkëmbrojtësin, para 5.



25. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ndaj të akuzuarit nuk shkaktohet dëm dhe rrjedhimisht konstaton se rishikimi nuk është i përligjur në këto rrethana. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se rishikimi aktual nuk e parandalon z. Haradinaj që t'i kundërshtojë arsyet për paraburgim ose të paraqesë kërkesë për lirim të përkohshëm në çdo kohë në përputhje me nenin 41 të Ligjit dhe rregullat 56 dhe 57 të Rregullores.

#### B. DYSHIMI I BAZUAR

26. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2012, Ligji Nr. 04/L-123, standardi provues i “dyshimit të bazuar” përkufizohet si “njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka më shumë gjasa që të ketë kryer veprën penale se sa që të mos e ketë kryer atë.”<sup>39</sup>

27. Z. Haradinaj nuk e kundërshton ekzistencën e dyshimit të bazuar për kryerjen e veprave penale. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, kur e ka konfirmuar Aktakuzën, ka konstatuar se ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Haradinaj ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të DHS-së, konkretisht: (i) pengim të personave zyrtarë në ushtrimin e detyrave zyrtare përmes kërcënimeve të rënda; (ii) pengim të personave zyrtarë në ushtrimin e detyrave zyrtare me veprime të përbashkëta si grup; (iii) frikësim gjatë procedimit penal; (iv) hakmarrje; (v) shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur; dhe (vi) shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit

---

<sup>39</sup> Vendimi për arrestim dhe transferim, para. 18. Shih gjithashtu nenin 5(1)(c) të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, interpretuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Fox, Campbell and Hartley v. United Kingdom*, no. 12245/86; 12383/86, Judgment, 30 August 1990, vol. 182, Series A, p. 16, para. 32; *K.-F. v. Germany*, no. 144/1996/765/962, Judgment, 27 November 1997, Reports 1997-VII, para. 57; *Labita v. Italy*, no. 26772/95, Judgment, 6 April 2000, para. 155; *Berktaş v. Turkey*, no. 22493/93, Judgment, 1 March 2001, para. 199; *O'Hara v. United Kingdom*, no. 37555/97, Judgment, 16 October 2001, para. 34.

dhe/ose të dhënave personale të personave të mbrojtur në kundërshtim me nenet 387, 388, 392 dhe 401 të KPK, në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.<sup>40</sup>

28. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përmbushet standardi i nenit 41(6)(a) të Ligjit.

#### C. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

29. Kur përmbushet standardi i nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që e lejojnë Gjykatësin e Procedurës Paraprake që t'i heqë lirinë një personi, duhet të jenë të artikulueshme.<sup>41</sup> Në këtë aspekt, kujtojmë se përcaktimi i ekzistencës së cilitdo rrezik sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit, për arsyetimin e domosdoshmërisë së paraburgimit të personit, ka të bëjë me vlerësimin e mundësisë së materializimit të rreziqeve të tilla, e jo të pashmangshmërisë të materializimit të tyre.<sup>42</sup>

#### 1. Rreziku i arratisjes

30. Sa i përket rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, z. Haradinaj parashtron se: (i) konstatimi se ai paraqet rrezik për arratisje është tërësisht i pambështetur në fakte dhe i pabazë dhe (ii) ai banon në Kosovë me familjen e tij dhe kurrë nuk ka tentuar ta fshehë vendndodhjen e tij dhe për këtë arsye nuk paraqet rrezik për arratisje.<sup>43</sup> ZPS-ja argumenton se rreziku ekzistues i arratisjes është rritur që

<sup>40</sup> Vendimi i konfirmimit, para. 103, 109, 113, 117, 121, 125.

<sup>41</sup> Neni 19.1.9 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

<sup>42</sup> KSC-BC-2020-07/IA001, F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi apelin e Hysni Gucatit për çështje të lidhura me arrestimin dhe mbajtjen e tij në paraburgim* ("Vendimi mbi apelin e Gucatit të vendimit të parë për paraburgimin"), 9 dhjetor 2020, publik, para. 67; Vendimi për arrestim dhe transferim, para. 19. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Bemba Gombo et al.*, ICC-01/05-01/13-558, Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr Aimé Kilolo Musamba against the decision of Pre-Trial Chamber II of 14 March 2014 entitled "Decision on the 'Demande de mise en liberté provisoire de Maître Aimé Kilolo Musamba'"](#), 11 July 2014, para. 107.

<sup>43</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 34(a).

nga vendimi i parë për paraburgimin si rezultat i dorëzimit të Aktakuzës së Konfirmuar dhe do të vazhdojë të rritet me vijimin e mëtejshëm të procesit.<sup>44</sup>

31. Z. Haradinaj pretendon përgjithësisht se konstatime e mëhershme për rrezikun e arratisjes së z. Haradinaj janë të pabaza, duke mos dhënë asnjë argument në mbështetje të këtij pretendimi. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimet e tij se: (i) tentimi i z. Haradinaj për t'iu ikur oficerëve të ZPS-së me automjet dhe në këmbë gjatë arrestimit e mbështet konstatimin se ai paraqet rrezik për arratisje; (ii) mosnjohja e DHS-së nga ana e tij tregon mungesë të vullnetit për t'u paraqitur para një institucioni për të cilin nuk ka respekt; (iii) fakti që ai ka shtetësi të BE-së gjithashtu mbështet konstatimin se ai paraqet rrezik për arratisje, meqenëse kjo shtetësi i mundëson që të udhëtojë me lehtësi në shumë juridiksione, përfshirë edhe ato që nuk kanë marrëveshje ekstradimi me Kosovën; dhe (iv) pavarësisht nga pagesa mujore që z. Haradinaj merr nga Organizata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("OVL UÇK") ose shuma e parave në dispozicion të organizatës, z. Haradinaj si zëvendëskryetar i kësaj organizate është në gjendje të kërkojë ndihmën e rrjetit dhe burimeve të OVL-së së UÇK-së, që vlerësohet se ka mbi 40000 anëtarë, që të tentojë të arratiset.<sup>45</sup>

32. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, që nga vendimi i parë për paraburgimin, ZPS-ja e ka dorëzuar Aktakuzën e Konfirmuar. Ky faktor ofron mbështetje shtesë për konstatimin se z. Haradinaj paraqet rrezik për arratisje meqenëse vë në dukje peshën e akuzave<sup>46</sup> dhe e bën më konkrete mundësinë e dënimit, duke ofruar kështu motiv për z. Haradinaj që të arratiset.

33. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se rreziku që z. Haradinaj të arratiset ekziston ende.

---

<sup>44</sup> Parashtrimi i ZPS-së, para. 4.

<sup>45</sup> KSC-BC-2020-07, F00058, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim në lidhje me kërkesën për lirim të menjëhershëm të Nasim Haradinajt*, 27 tetor 2020, publik, para. 21.

<sup>46</sup> Vendim mbi apelin e Gucatit të vendimit të parë për paraburgimin, para. 71-72.

## 2. Pengimi i ecurisë së procedimit penal

34. Sa i përket rrezikut për pengimin e procedimit penal sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, z. Haradinaj parashtron se nuk ka arsye për të sugjeruar se është përpjekur që t'i pengojë hetimet meqenëse ai nuk përdori kërcënime për marrjen e dokumenteve, ose nuk tentoi të merrte apo të ndihmonte në nxjerrjen e dokumenteve në lidhje me hetimet e ZPS-së. Z. Haradinaj gjithashtu parashtron se eventualisht dokumentet përkatëse u sekuestruan dhe si rrjedhojë, urdhrat e Gjykatësit të Vetëm u respektuan.<sup>47</sup> ZPS-ja pretendon se rreziku ekzistues i pengimit është rritur që nga vendimi i parë për paraburgimin dhe do të vazhdojë të rritet me vijimin e mëtejshëm të procesit.<sup>48</sup>

35. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimin e tij të mëparshëm se z. Haradinaj ka deklaruar publikisht se ai do të vazhdonte të shpërndante informacion konfidencial dhe jopublik,<sup>49</sup> përkundër urdhrave të Gjykatësit të Vetëm drejtuar OVL-së të UÇK-së për të ndaluar shpërndarjen.<sup>50</sup>

36. Sekuestrimi i informacionit konfidencial dhe jopublik përkatës nga ZPS-ja, nuk e eliminon synimin e z. Haradinaj për shpërndarjen e një informacioni të tillë nëse i vjen mundësia. Në fakt, në dy raste, z. Haradinaj mori pjesë në konferenca për shtyp në lidhje me dokumentet konfidenciale dhe jopublike, pasi ishin kryer sekuestrime të autorizuara.<sup>51</sup>

<sup>47</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 33(b).

<sup>48</sup> Parashtrimi i ZPS-së, para. 4.

<sup>49</sup> Vendimi i parë për paraburgimin, para. 24, që citon KSC-BC-2020-07, F0009/RED/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to* ("Shtojca 1 e kërkesës së ZPS-së për fletarrestime"), 1 tetor 2020, publike, f. 5-6; KSC-BC-2020-07, F0009/RED/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to* ("Shtojca 1 e kërkesës së ZPS-së për fletarrestime"), 1 tetor 2020, publike, f. 8.

<sup>50</sup> SC-BC-2020-07, F00005, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim urgjent që autorizon sekuestrim* ("Urdhri i parë"), 24 shtator 2020, publik, paragrafi 22; KSC-BC-2020-07, F00007, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim që autorizon sekuestrim* ("Urdhri i dytë"), 17 shtator 2020, publik, para. 22.

<sup>51</sup> Vendimi i parë për paraburgimin, para. 24, ku citohet shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime; Shtojca 2 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime; Urdhri i parë; Urdhri i dytë.

37. Në kundërshtim me parashtrimet e z. Haradinaj, fakti që ai nuk tentoi të merrte dokumente konfidenciale dhe jopublike, me kërcënime ose me metoda të tjera, nuk e pengoi që ta shpërndante një informacion të tillë pasi kishte fituar qasje në të.

38. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton në këtë aspekt se urdhrat e Gjykatësit të Vetëm nuk kishin të bënin vetëm me sekuestrimin e dokumenteve të caktuara, por gjithashtu konfirmonin natyrën e ndjeshme të informacionit nga hetimet e TFHS/ZPS-së dhe paralajmëronin që këto dokumente, *dhe/ose përmbajtja e tyre*, të mos shpërndaheshin.<sup>52</sup> Përkundër këtyre paralajmërimeve, në konferencën e dytë për ecurinë e çështjes z. Haradinaj, zbuloi emra individësh dhe informacion që kishte të bënte me hetime konfidenciale,<sup>53</sup> iu tha të pranishmëve në konferencën për shtyp që mund t'i merrnin dokumentet,<sup>54</sup> premtoi se do të vazhdonte shpërndarjen e dokumenteve që do t'i jepeshin OVL-së së UÇK-së<sup>55</sup> dhe deklaroi se përpiquej që të diskreditonte punën e DHS-së.<sup>56</sup> Ngjashëm, në konferencën e tretë për ecurinë e çështjes, z. Haradinaj zbuloi emra individësh dhe informacion tjetër lidhur me hetimet konfidenciale,<sup>57</sup> i ftoi të pranishmit që t'i shikonin, incizonin ose t'i bënin publike përmbajtjet e dokumenteve,<sup>58</sup> dhe deklaroi qëllimin e tij për shpërndarjen e mëtejshme të informacionit konfidencial dhe jopublik.<sup>59</sup>

39. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ende ekziston rreziku që z. Haradinaj mund të pengojë zhvillimin e procesit.

### 3. Kryerja e veprave penale të tjera

---

<sup>52</sup> Urdhri i parë, para. 21, 22, 25; Urdhri i dytë, para. 21, 22, 25.

<sup>53</sup> Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 8-9, 11.

<sup>54</sup> Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 10.

<sup>55</sup> Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 11.

<sup>56</sup> Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 10-11.

<sup>57</sup> Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 14-15.

<sup>58</sup> Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 15, 16-17, 20, 24.

<sup>59</sup> Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 15-17.

40. Sa i përket rrezikut të kryerjes së veprave të tjera penale, sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, z. Haradinaj parashtron se karakteri i tij i mirë dhe lidhjet e ngushta familjare dhe me komunitetin tregojnë se nuk ka pasur probleme me sjelljen e tij të mëparshme, ose nuk ekzistojnë rrethana personale që mund të ngrenë shqetësime se mund të kryejë vepra penale të tjera.<sup>60</sup>

41. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se karakteri i z. Haradinaj ose lidhjet me familjen dhe komunitetin nuk e kanë penguar që të shpërndajë informacion konfidencial dhe jopublik duke marrë parasysh zotimin e tij të deklaruar publikisht për të vazhduar me shpërndarjen e një informacioni të tillë.<sup>61</sup> Si rrjedhojë, për arsyet e diskutuara më lart lidhur me pengimin e procedimit penal, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ende ekziston rreziku që z. Haradinaj mund të kryejë vepra penale të tjera duke kërcënuar, frikësuar ose rrezikuar dëshmitarë (të mundshëm) përmes nxjerrjes ose shpërndarjes të informacionit konfidencial dhe jopublik.

#### 4. Përfundim

42. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se parashtrimet e z. Haradinaj nuk e cenojnë konstatimin se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekzistojnë të tri rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii).<sup>62</sup>

#### D. LIRIMI ME KUSHT

43. Si alternativë, z. Haradinaj kërkon lirim me kusht dhe propozon kushtet në vijim për të zbutur rreziqet e perceptuara: (i) dorëzimin e pasaportës së tij; (ii) urdhrin për të qëndruar në Kosovë në një adresë të caktuar; (iii) regjistrimin në ZPS, të pajisjeve

---

<sup>60</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 34(c).

<sup>61</sup> Vendimi i parë për paraburgimin, para. 24, *ku citohet* shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 5-6. Shtojca 2 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 8.

<sup>62</sup> Vendimi për arrestim dhe transferim, para. 27-31.

elektronike që përdoren për komunikim; (iv) raportimin e rregullt në stacionin policor lokal; (v) ndalimin e kontaktimit me të bashkakuzuarin; dhe (vi) ndalimin e komunikimit me media ose publikimit të informacionit që ka të bëjë me çështjet përpara DHS-së.<sup>63</sup> Z. Haradinaj deklaroi se këto kushte sigurojnë vendndodhjen e tij, parandalojnë komunikimin me individët përkatës dhe e parandalojnë që të shpërndajë informacion ose material që mund të cenojë çështje aktuale ose të ardhshme.<sup>64</sup>

44. Sa i përket rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se dorëzimi i pasaportës, qëndrimi në Kosovë në një adresë të caktuar dhe raportimi i rregullt në stacionin policor lokal janë kushte që përgjithësisht do ta zbusnin këtë rrezik. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se këto kushte janë të pamjaftueshme duke pasur parasysh përpjekjet e z. Haradinaj për t'iu ikur oficerëve të ZPS-së gjatë arrestimit, mosnjohjen e DHS-së prej tij, dhe shtetësinë e BE-së që do t'i mundësonte të udhëtonte me lehtësi në juridiksione që nuk kanë marrëveshje për ekstradim me Kosovën.<sup>65</sup> Megjithatë Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje në mënyrë të favorshme lidhjet e ngushta të z. Haradinaj me familjen dhe komunitetin në qytetin ku banon,<sup>66</sup> përpjekja e tij e mëhershme për t'iu shmangur arrestimit i zhbalkancon lidhjet e tilla të cilat për pasojë nuk e zbusin mjaftueshëm rrezikun e arratisjes.

45. Sa i përket rrezikut të pengimit të procesit ose të kryerjes e veprave të tjera penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se kushtet, si regjistrimi i pajisjeve elektronike, ndalimi i kontaktimit me të bashkakuzuarin dhe median, ose të publikimit të informacionit për çështje para DHS-së, faktikisht kanë për qëllim zbutjen e këtyre rreziqeve. Sidoqoftë, duke marrë parasysh mosrespektimin prej z. Haradinaj

---

<sup>63</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 35.

<sup>64</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 36.

<sup>65</sup> Vendimi i parë për paraburgimin, para. 21.

<sup>66</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 34(c).

të urdhrave të Gjykatësit të Vetëm në dy raste të mëparshme,<sup>67</sup> deklaratën e tij se do të vazhdojë me shpërndarjen e dokumenteve dhe informacionit konfidencial dhe jopublik,<sup>68</sup> dhe mosnjohjen e DHS-së prej tij,<sup>69</sup> nuk mund të besohet asnjë garanci personale për moskontaktimin me të bashkakuzuarin apo median ose mospublikimin e informacionit lidhur me çështje para DHS-së. Nëse lirohet, z. Haradinaj do të ishte në gjendje të merrte, pa mbikëqyrje, informacion konfidencial dhe jopublik. Regjistrimi i pajisjeve elektronike nuk do ta pengonte z. Haradinaj që të merrte ose shpërndante informacion konfidencial ose jopublik. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se lirimi me kusht do të ishte i pamjaftueshëm për të tejkaluar rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të identifikuar më lart.

46. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, meqenëse asnjë nga kushtet e propozuara nga z. Haradinaj nuk është i mjaftueshëm për të zbutur rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të përmendura më lart, lirimi me kusht duhet të refuzohet.

#### E. KËRKESË PËR SEANCË GOJORE

47. Z. Haradinaj i bashkohet kërkesës së z. Gucati për seancë gojore për të plotësuar parashtrimet e tij me shkrim lidhur me rishikimin e paraburgimit dhe për t'iu përgjigjur parashtrimeve të ZPS-së.<sup>70</sup>

48. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton vendimin e tij të nxjerrë më 18 dhjetor 2002, në të cilin refuzoi kërkesën e z. Gucati për seancë gojore në lidhje me procesin e rishikimit të paraburgimit aktual dymujor.<sup>71</sup> Për të njëjtat arsye, refuzohet kërkesa e z.

---

<sup>67</sup> Urdhri i parë, para. 22; Urdhri i dytë, para. 22.

<sup>68</sup> Shtojca 1 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 5-6; Shtojca 2 e Kërkesës së ZPS-së për fletarrestime, f. 8.

<sup>69</sup> KSC-BC-2020-07, Transkript, 29 shtator 2020, publik, f. 17, rreshti 13, deri f. 18, rreshti 5.

<sup>70</sup> Parashtrimi i Mbrojtjes, para. 37-54.

<sup>71</sup> KSC-BC-2020-07, F00089, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së seancës për vetëdeklarim në lidhje me fajësinë ose pafajësinë dhe të konferencës së parë për ecurinë e çështjes dhe çështje të lidhura me to*, 18 dhjetor 2020, publik, para. 3, 16-17.



Haradinaj për seancë gojore. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ka informacion të mjaftueshëm për të nxjerrë vendimin aktual dhe në këtë fazë nuk janë të nevojshme parashtrime të tjera, me shkrim apo me gojë.<sup>72</sup>

49. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, ndërsa refuzohet kërkesa për seancë gojore dhe kërkesa për të paraqitur kundërpërgjigje, kjo nuk e pengon z. Haradinaj që të paraqesë kundërshtime të veçanta të paraburgimit ose kërkesa për lirim të përkohshëm ose me kusht sipas nenit 41(2) dhe (12) të Ligjit dhe rregullave 56(3) dhe 57(2) të Rregullores në çdo moment në periudhën ndërmjet rishikimeve të detyrueshme dymujore të paraburgimit.

50. Në fund, për të ndihmuar në rishikimin e ardhshëm dymujor të paraburgimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e urdhëron z. Haradinaj që t'i paraqesë deri të hënën, 1 shkurt 2021, parashtrime nëse ekzistojnë ende arsye për vazhdimin e paraburgimit të tij. Përgjigjet dhe kundërpërgjigjet ndaj këtyre parashtrimeve dorëzohen në përputhje me afatet e përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

## V. VENDIM

51. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Haradinaj;
- b. **REFUZON** kërkesën e z. Haradinaj për seancë gojore; dhe
- c. **URDHËRON** z. Haradinaj që deri të hënën, 1 shkurt 2021 të paraqesë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**

<sup>72</sup> *Shih*, në lidhje me këtë, Vendimi mbi apelin e Gucatit të vendimit të parë për paraburgimin, para. 77.

## **Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

E enjte, 24 dhjetor 2020

Në Hagë, Holandë